

RELACION TEKNIK

OBJEKTI : Veshje me tavan i tendave, me sistem ndricimi ne terminalet e hyrjes dhe te daljes te doganes Kakavije

POROSITES : Dogana Kakavije

Qellimi i projektit : Permiresimi i situates funksionale dhe estetike te terminaleve te hyrjes dhe te daljes te doganes Kakavije.

Pershkrim i gjendjes ekzistuese : Korridoret e levizjes se mjeteve ne terminalet hyrese dhe dalese te doganes se Kakavijes jane te mbuluara prej dy tendash simetrike ne trajte dretkendeshi kendrejte me brinjen me te gjate ne drejtimin veri –jug me konstruksion llamarine te valezuar per te lehtesuar kullimin e ujrave me sipërfaqe respektivisht 290 m² secila. Mbulesa eshte e mbeshtetur ne nje kapriate hapesinore me lartesi 1m e realizuar prej profilash metalike me seksion 45x50x4mm te bashkuar me bulona ne nyje metalike speciale ne forme pllakash. Kapriata ne vetvete eshte e mbeshtetur ne gjashte shtylla metalike me konstruksion kompozit (pjeserisht kolone rumbullake dhe pjeserisht kapriate hapesinore). Kullimi I ujrave realizohet pergjate brinjes veriore permes nje ulluku metalik horizontal me shkarkime vertikale prej tubash metalike te vendosura pergjate kolonave respective te skajeve veriore te konstruksionit. Hapesira e krijuar pergjate brinjeve anesore te mbuleses deri tek baza e kapriates horizontale eshte mbuluar me nje panel special ne trajte ¼ rrethi me rreze 115cm. Keta elemente ne situaten aktuale paraqiten te demtuar seriozisht duke krijuar edhe rreziqe aksidentimesh.

Ndricimi i hapesires poshte tendes arrihet permes ndricuesash te varur te montuar ne bazen e kapriates horizontale.

Ne pikpamje te cilesise se ndricimit te hapesires (ndricimi I manget) duket se keta ndricuesa nuk mund t'a kryejne me funksionin e tyre fillestar.

Gjithashtu situata estetike e ndricuesave si dhe e kapriatave metalike nuk e justifikon paraqitjen e nje institucioni te nje rendesie kaq te vecante.

Me kalimin e viteve ato jane demtuar ne menyre veshtiresisht te riparueshme.

Punimet e reja : Konsistojne ne permiresimin funksional dhe estetik te ndricimit te hapesires poshte tendave si dhe mbulimin konstruksioneve ekzistuese te demtuara me materiale te reja bashkekohore.

Panelet ekzistuese mbyllese anesore te kapriates horizontale duhen hequr dhe zevendesuar me panele te reja. Panelet e reja do te realizohen prej materialesh bashkekohore me te rezistueshme dhe me estetike prej fletesh alumini (alukobond) me trashesi 4mm te kalandruara dhe te lyera me pjekje qe me pare. Konstruksioni i demtuar i strukturave mbeshtetese te tyre do te zevendesohet me te njejtat materiale.

Mbulimi i hapësirës së poshtme të kapriatës horizontale do të realizohet me një tavan horizontal prej materiali të njëjte me atë të paneleve anësore duke lënë hapësirat e nevojshme për ndricuesat.

Hapësirat e tavanit që do të lihen të hapura për arsye të konstruksionit të kolonave mbështetëse të kapriatës horizontale është menduar të maskohen po prej të njëjtave panele duke mbuluar vetëm lartësinë e kolonës të realizuar me kapriatë. Pjesa e mbështetësit në trajtë kolone rrumbullake do të lihet siç është.

Në konstruksionin e tavanit do të montohen ndricuesa të rinj bashkëkohore me fuqi të mjaftueshme ndricimi – 20 ndricuesa për çdo tendë – të fshehur dhe me formë katrore (50x50cm).

Propozohet që panelet e tavanit dhe të veshjeve anësore të jenë në ngjyrë të bardhë ose pana ndërsa panelet veshëse të kolonave në ngjyrë jeshile të lehtë (celadon) të kolonave të rrumbullakta.